



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: 463-01/11974, dt. 28 Shkurt 2025

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit të Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat Visar (Rifat) Tigani dhe Kreshnik (Rifat) Tigani, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 28 Shkurt 2025, mori këtë:

VENDIM

Nr. 08/2025

Mbi miratimin për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Visar (Rifat) Tigani dhe Kreshnik (Rifat) Tigani me qëllim të Rregullimit të Shtratit të Lumbardhit – Shëtitore dhe Hapësirë e Hapur Publike si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të rregullimit të shtratit të Lumbardhit – shëtitore dhe hapësirë e hapur publike si Interes Publik, sipas Planit Zhvillimor Komunal.
- II. Parcelat kadastrale nr.2262-5 në sipërfaqe prej 13m² ZK Pejë dhe nr.2262-7 në sipërfaqe prej 22m² ZK Pejë në pronësi të Visar (Rifat) Tigani me ½ dhe Kreshnik (Rifat) Tigani me ½ do të merren për nevoja të rregullimit të shtratit të Lumbardhit - shëtitore dhe hapësirë e hapur publike si Interes Publik sipas Planit Zhvillimor Komunal dhe në të njëjtën kohë do të jenë objekt këmbimi me parcelat kadastrale nr.6191-3 në sipërfaqe prej 9m² ZK Pejë dhe nr.2257-6 në sipërfaqe prej 23m² ZK Pejë, pronë **Komuna e Pejës**.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 12.02.2025.
 - Pronat e Komunës, ngastrat kadastrale nr.6191-3 në sipërfaqe prej 9m² ZK Pejë dhe 2257-6 në sipërfaqe prej 23 m² janë vlerësuar 750.00 €/m², përkatësisht totali 24,000.00 €
 - Prona private në pronësi të Visar (Rifat) Tigani me ½ dhe Kreshnik (Rifat) Tigani me ½ me numër kadastral 2262-5 në sipërfaqe prej 13m² ZK Pejë dhe nr.2262-7 në sipërfaqe prej 22m² ZK Pejë janë vlerësuar 750.00 €/m², përkatësisht totali 26,250.00 €.

Andaj obligohet Komuna e Pejës të paguaj diferencën në shumën prej 2,250.00 € Visar (Rifat) Tiganit dhe Kreshnik (Rifat) Tiganit bazuar në Vlerësimin e bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë.

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do ti nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Çështje Pronësore-Juridike.
- VI. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

*MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.*

